

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë



**Plani strategjik
i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë
për periudhën 2015-2017**

maj 2014

Në bazë të nenit 47 paragrafi 1 pika 9 të Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12 dhe 43/14) dhe neni 12 paragrafi 6 të Rregullores për planifikim Rr. nr. 02-15/VIII-2/2013 nga 1 gusht i vitit 2013, Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi:

Planin strategjik të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë për periudhën 2015-2017

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Plani strategjik i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore) paraqet dokument fillestar në procesin e planifikimit strategjik dhe jep vizionin strategjik të Bankës Popullore në periudhën e ardhshme tre vjeçare.
2. Plani strategjik i Bankës Popullore rishikohet çdo vit dhe paraqet bazë për përgatitjen e Drejtimeve për punë të Bankës Popullore dhe Programin e punës së Bankës Popullore me të cilën përcaktohen programet vjetore për realizimin e qëllimeve, ndjekjen e realizimit të tyre dhe ndërmarrjes së masave të duhura në kohë.
3. Plani strategjik i Bankës Popullore siguron plotësueshmërinë e planeve të njësive organizative me qëllim të realizimit efikas të objektivave të përcaktuara dhe vërteton përparësinë e përdorimit të burimeve në dispozicion.
4. Plani strategjik i Bankës Popullore përcakton misionin, vizionin për të ardhmen, vlerat organizative dhe qëllimet strategjike të Bankës Popullore, në varshmëri nga mjedisi makroekonomik dhe sfidave kryesore të periudhës së ardhshme.

Qëllimet strategjike, për sa i përket këtij plani strategjik, janë të ndara në qëllimet strategjike themelore dhe qëllimet strategjike që kontribuojnë në realizimin e qëllimeve strategjike themelore.

II. MISIONI

5. Misioni i Bankës Popullore është të ruaj stabilitetin e çmimeve si dhe stabilitetin financiar dhe të kontribuoj në rritjen e mirëqenies ekonomike dhe standardit jetësorë të qytetarëve.

III. VIZIONI

6. Vizioni i Bankës Popullore është që ajo të njihet si e pavarur, përgjegjëse, profesionale dhe institucion transparent që gëzon besim të lartë dhe kredibilitet në opinion.

IV. VLERAT

7. Gjatë realizimit të qëllimeve, Banka Popullore edhe më tej do të nxisë dhe do të ruaj vlerat në vazhdim:

Kualitet - realizimi i qëllimeve dhe pritshmërive të të punësuarve, dhe të personave fizik dhe juridik të vendit dhe të jashtëm, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të standardeve të punës, në pajtueshmëri me praktikën më të mira ndërkombëtare;

Integritet - sigurimi i konsistencës, saktësisë dhe ndershmërisë gjatë realizimit të qëllimeve dhe aktiviteteve;

Lojalitet (Besnikëri) - dhënia përparësi realizimit të interesave të Bankës Popullore në raport me interesat e individëve ose grupeve dhe përkushtimi për arritjen e misionit, vizionit dhe qëllimeve strategjike të institucionit;

Transparenca – sigurim të informimit të saktë dhe në kohë të të punësuarve dhe personave fizik dhe juridik të vendit dhe të jashtëm lidhur me vendimet dhe masat e Bankës Popullore;

Udhëheqja (Lidershipi) - mbështetje tek ambiciet e shëndosha, intelekti dhe vetë disiplina e ndërtuar në bazë të besimit të ndërsjellë tek të punësuarit;

Inovacionet - stimulimi i inovacioneve, përmirësim i qëndrueshëm dhe të menduarit kritik; Profesionalizmi- Vlerësime të shëndosha dhe kapacitet i lartë intelektual;

Puna në ekip (Shpirti i ekipit) - sigurimi i sinergjisë dhe kultura e shpërndarjes së dijes dhe puna në ekip.

V. MJEDISI MAKROEKONOMIK DHE SFIDAT KRYESORE

8. Ambienti ku do të realizohen qëllimet strategjike dhe obligimet e Bankës Popullore në periudhën e ardhshme tre vjeçare, vlerësohet si më stabil, gjegjësisht periudhë në të cilën gradualisht do të shteren efektet e krizës së fundit globale.. Megjithatë, edhe më tej ekziston pasiguria në lidhje me rimëkëmbjen globale, ndjeshmëria potenciale në segmente të caktuara, si dhe rreziqe jo të favorshme të natyrës ekonomike dhe jo ekonomike. Domethënë, pavarësisht stabilizimit gradual të rrjedhave ekonomike financiare pas masave të ndërmarra fiskale dhe monetare, si rezultat i ndjeshmërisë së sektorit financiar dhe financave publike në më shumë vende, dinamika e rimëkëmbjes ekonomike në suaza globale, edhe më tej është e pasigurt dhe është e shoqëruar me rreziqe. Në një mjedis të tillë, Banka Popullore do të ndjek rregullisht tendencat globale dhe në përputhje me dinamikën e rimëkëmbjes së ekonomisë vendore, do të vlerësohet nevoja për rregullimin (përshtatshmërinë) e duhur të politikës monetare. Me qëllim të rritjes së kapacitetit për zbulimin në kohë të rreziqeve eventuale, si dhe për shqyrtim të lëvizjeve dhe ndryshimet në mjedis, Banka Popullore edhe më tej do të vazhdojë të avancojë punën analitike dhe hulumtuese. Korniza operative e politikës monetare, si deri më tani, do të vendoset në një bazë fleksibile dhe në dobi të menaxhimit efektiv me likuiditetin e sistemit bankar dhe mbajtjes së balancit në tregun valutor. Menaxhimi me rezervat valutore do të realizohet në përputhje me lëvizjet makroekonomike, kushtet e brendshme dhe ndërkombëtare, duke respektuar parimet e sigurisë, likuiditetit dhe profitabilitetit. Kështu, politika monetare do të

vazhdojë të kontribuojë në stabilitetin e përgjithshëm makroekonomik, si një faktor kyç në krijimin e një ambientit të favorshme për rritje të qëndrueshme ekonomike.

Duke pasur parasysh objektivin ligjërish të përcaktuar për ruajtjen e stabilitetit të sistemit bankar dhe financiar, do të vazhdojnë aktivitetet për forcimin e mbikëqyrjes bankare. Duke ndjekur tendencat e UE-së, më shumë vëmendje do t'u kushtohet bankave me rëndësi sistematike, si dhe përshtatjes graduale kah standardet të reja ndërkombëtare bankare dhe praktikave mbikëqyrëse. Gjithashtu, në vazhdimësi do të përmirësohen dhe do të thellohen analizat e sistemit bankar, stabiliteti i tij dhe rezistenca ndaj goditjeve, si dhe stabiliteti i përgjithshëm financiar në vend.

Në kuadër të angazhimit strategjik të Republikës së Maqedonisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe në rritjen e pritshme të mëtejshme të shkallës së integritit të ekonomisë sonë në kuadër të ekonomisë globale, aktivitetet e Bankës Popullore edhe më tej do të jenë të drejtuara kah arritja graduale e kërkesave të BE-së dhe Sistemit Evropian të Bankave Qendrore.

Arritja e qëllimeve strategjike kërkon monitorim aktiv të tendencave në veprimtarinë e bankave qendrore, forcim të mëtejshëm të kapacitetit institucional si dhe avancim dhe zhvillim të kapitalit njerëzor.

VI. QËLLIMET STRATEGJIKE TË BANKËS POPULLORE

9. Qëllimet strategjike themelore janë:

- 9.1. Në periudhën e ardhshme tre vjeçare, Banka Popullore edhe më tej do të vazhdojë të jetë e fokusuar kah ruajtja e suksesshme e stabilitetit të çmimeve, nëpërmjet zbatimit të strategjisë së zgjedhur monetare të ruajtjes së kursit stabil të denarit kundrejt euros.
- 9.2. Banka Popullore edhe më tej do të japi kontribut në ruajtjen e stabilitetit dhe sigurisë së sistemit bankar, si parakusht themelor për stabilitet financiar.
- 9.3. Banka Popullore edhe më tej do të vazhdojë të mbështesë politikën e përgjithshme ekonomike, pa rrezikuar realizimin e qëllimit kryesor, arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, në përputhje me parimin e një ekonomie tregu të hapur me konkurrencë të lirë.

10. Qëllimet strategjike në varësi nga fusha e punës së Bankës Popullore janë:

10.1. Përcaktimi dhe zbatimi i politikës monetare dhe mbështetje e tregjeve financiare

- Përpunimi në kohë dhe me cilësi të lartë i projeksioneve dhe analizave makroekonomike, si mbështetje në procesin e marrjes së vendimeve për politikën monetare;
- Përshtatja e kornizës operative të politikës monetare në përputhje me kushtet e tregut dhe lëvizjeve ekonomike;

- Mbështetja e zhvillimit të tregjeve financiare për transmetim efikas të politikës monetare dhe për ndërmjetësimin financiar më të thelluar;
- Ndikimi mbi pritjet e subjekteve ekonomike për shkak të arritjes së transmetimit efektiv të politikës monetare, duke publikuar raporte të rregullta të BPRM me shqyrtime të qarta për lëvizjet e ardhshme ekonomike dhe informacione.

10.2. Menaxhimi i rezervave devizore të Republikës së Maqedonisë

- Përmirësimi i procesit të menaxhimit me rezervat devizore dhe ruajtja e fleksibilitet të lartë gjatë menaxhimit, duke filluar nga parimet e sigurisë, likuiditetit dhe profitabilitetit;
- Diversifikimi i rezervave devizore nga emetuesit, valutat dhe instrumentet shkak të menaxhimit me rrezikun e kredisë, rrezikun e likuiditetit, rrezikun e valutës dhe rrezikun e normës së interesit.

10.3. Stabiliteti financiar

- Përmirësimi i mëtejshëm i mbikëqyrjes së bankave dhe të kursimoreve;
- Thellimi i analizave për stabilitetin financiar;
- Avancimi i vazhdueshëm i rregullativës bankare, duke pas parasysh parimet e reja të Bazelit për mbikëqyrje efikase bankare dhe Direktivën dhe rregullativën e re evropiane lidhur me veprimtarinë bankare.
- Zgjerimi i bashkëpunimit me organe të tjera financiare mbikëqyrëse, Fondi për Sigurim të depozitave dhe Ministria e Financave.

10.4. Lëshimi (emetimi) dhe menaxhimi i kartëmonedhave dhe monedhave të Republikës Maqedoni

- Rritja e efikasitetit të sistemit për furnizim dhe përpunim të kartëmonedhave dhe monedhave;
- Rritja e kualitetit dhe funksionalitetit të parave të gatshme në qarkullim.

10.5. Sistemet e pagesave

- Ruajtja e nivelit më të lartë të sigurisë, stabilitetit dhe efikasitetit të sistemeve të pagesave;
- Përshtatja e kornizës për mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave sipas standardeve të reja të pranuar ndërkombëtarisht për punën e sistemeve të pagesave.

10.6. Statistika

- Futja e statistikave të reja dhe harmonizimin e statistikave ekzistuese që janë nën kompetencat e Bankës Popullore me standardet ndërkombëtare dhe përshtatja e tyre me kërkesat e Bashkimit Evropian si dhe rritja e vëllimit dhe hollësisë së të dhënave që u dorëzohen përdoruesve.

10.7. Studime dhe hulumtime në fushën e ekonomisë dhe financave

- Zhvillimi i veprimtarisë hulumtuese në fushat që janë të një rëndësie kyçe për realizim efektiv të qëllimeve të Bankës Popullore.

10.8. Teknologjia e informacionit

- Përpunim i shpejtë dhe efikas i të dhënave dhe krijimi i informacionit për të lehtësuar vendimmarrjen duke përmirësuar sistemet e informacionit në Bankën Popullore, në përputhje me praktikatat më të mira ndërkombëtare nga fusha e menaxhimit të shërbimeve të TI-së.

10.9. Auditimi i brendshëm

- Mirëmbajtja e pajtueshmërisë së plotë të punës së auditimit të brendshëm me Standardet për praktikë profesionale të auditimit të brendshëm;
- Përmirësimi i cilësisë së auditimit dhe aktiviteteve përkatëse;
- Përmirësimi i procesit të vetëvlerësimit të brendshëm në punën e auditimit të brendshëm.

10.10. Menaxhimi i përgjithshëm

- Zhvillimi dhe përmirësimi i planifikimit strategjik, si bazë për vizion afatmesëm të punës, për shkak të avancimit të menaxhimit korporativ, shpërndarjes optimale të burimeve për të arritur qëllimet prioritare dhe strukturës institucionale dhe organizimit;
- Përgatitja e Bankës Popullore për bashkim dhe anëtarësim në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore, duke forcuar gradualisht kapacitetet administrative, si dhe pjesëmarrjen e Bankës Popullore në aktivitetet reformuese të shtetit për të përmbushur detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi i Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian;
- Vendosja e një kornize të strukturuar për identifikim dhe menaxhim me rreziqet për shkak të zbutjes së ndikimit të pasigurisë në punë, rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit në realizimin e qëllimeve strategjike dhe detyrimeve të Bankës Popullore;
- Vendosja e një sistemi të integruar dhe më efikas për menaxhim të financave të Bankës Popullore;
- Forcimi i menaxhimit me burimet njerëzore;
- Përmirësimi i legjisllacionit me qëllim të zbulimit dhe minimizimit të rreziqeve ligjore gjatë arritjes së qëllimeve dhe përmbushjes së detyrave të Bankës Popullore, dhe monitorim dhe kontroll të përputhshmërisë së akteve të Bankës Popullore me rregullat në vend;
- Sigurimi i kushteve optimale të punës në kuadër të mjedisit fizik, në përputhje me kërkesat e biznesit dhe nevojat e Bankës Popullore dhe standardet dhe normat të përcaktuara në Republikën e Maqedonisë;
- Rritja e gatishmërisë për menaxhim në situata krize, në kuptim të mbrojtjes së njerëzve, të mirave materiale dhe të dhënave dhe informatave kyçe, si dhe vendosja e kushteve për realizimin normal të proceseve të biznesit në periudhë të arsyeshme kohore;

- Rritja e transparencës në punë, zgjerimi i komunikimit me publikun dhe zhvillim i mëtejshëm i edukimi financiar;
- Zhvillimi i veprimtarisë së muzeumeve, bibliotekës dhe arkivit historik.

VI. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

9. Plani strategjik i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë për periudhën 2015-2017, hyn në fuqi në ditën e miratimit, ndërsa do të zbatohet nga 1 janari i vitit 2015.

10. Plani strategjik i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë për periudhën 2014-2016, shfuqizohet nga 1 janari i vitit 2015.

P.S.Nr.02-15/VI-1/2014

29 maj 2014

Shkup

**Guvernator
dhe Kryetar i
Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov**